



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK.nr.413/2021**  
**Datë: 29 dhjetor 2021**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në takimin 274-të, të mbajtur më datë 29 dhjetor 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Autorizohet Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të merr pjesë për monitorim në Komitetin Drejtues të Strategjisë së Sundimit të Ligjit 2021 – 2026.
- II. Vendimi hyn në fuqi më 29 dhjetor 2021.

**A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga Ministria e Drejtësisë (MD) “Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026” (Strategjia) dhe “Planin e Veprimit 2021-2023” për të cilat ka kërkuar mbështetje për procedim të mëtutjeshëm.

Gjate analizimit të strategjisë dhe planit të veprimit është konstatuar se një numër aktivitete janë përfunduar, numër tjetër i konsiderueshëm janë në proces të implementimit si dhe disa prej tyre ngrisin shqetësime mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Pas koordinimit shtesë ndër-institucional lidhur me aktivitetet që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit, ky koordinim ka qartësuar për palët qëndrimin e KGJK-së lidhur me të gjitha aktivitetet dhe propozimet që rrjedhin nga Strategjia.

Këshilli, i ka marrë plotësisht parasysh aktivitetet që dalin nga Strategjia e të cilat, në qëndrimin e Këshillit, nuk cenojnë pavarësinë e gjyqësorit. Në këtë drejtim të gjithë mekanizmat e Këshillit janë kujdesur që përgjatë transpozimit të aktiviteteve nga Strategjia tek Plani i Punës i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (2022) aktivitetet të formulohen ashtu që të ruhet dhe mbrohet pavarësia e gjyqësorit dhe ndarja e pushteteve.

Këshilli, me qëllim që të jetë i informuar për progresin dhe zhvillimet që dalin nga strategjia, ka konsideruar të nevojshme pjesëmarrjen e kryesuesit për monitorim në Komitetin Drejtues për Strategjinë për Sundimin e Ligjit për vitin 2021 – 2026.

Andaj, nga e u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;*
- *Arkivit.*